

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bardhi: Qeveria po përgatit KAYO-n edhe në shëndetësi, socialistët janë kthyer në noterë të Edi Ramës – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/bardhi-qeveria-po-pergatit-kayo-n-edhe-ne-shendetesi-socialist-et-jane-khyer-ne-notere-te-edi-rames/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 16:46:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 15:29:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2a570544ceb36204c6c8de604482c308d380c0227251f8f3aa296c7a449a10ea
TEKSTI	50ed560689ab2e106cd913e127593c88543a4d6176e86a2f9b338ede30797832
PAMJA	f4af8f5bd4fc6d0b4b4136c0523c7329d8986c74b879484b4b08dd25f4a25d47

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2ab2ff4d792bc756b09b99d57250f72e52d52a4d74e83d04d5d431ce98d1416c
E MËPARSHMJA	14d4b0c2ab3c645c755b2385ee3ddbecea6f5bb59235ff35375adeb0be037229
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2ab2ff4d792bc756b09b99d57250f72e52d52a4d74e83d04d5d431ce98d1416c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, duke iu referuar deklaratave të bëra nga ish-zv.kryeministri Arben Ahmetaj, akuzoi qeverinë dhe kryeministrin Rama se pas skandalit të KAYO-s për armët, pritet të ndodhë një tjetër skandal, këtë herë në sistemin e shëndetësisë.

Sipas Bardhit, qeveria Rama dhe mazhoranca po planifikojnë të përqendrojnë sistemin shëndetësor në një dorë të vetme, duke djegur në këtë mënyrë konkurrencën e lirë.

“Siç është katandisur ky parlament, nuk ka më dilema se ky parlament do të vijojë kokeulur të votojë vetëm ligjet e Edi Ramës, programet e Ramës për Shqipërinë si tokë e djegur, ku mundësitë për shqiptarët e ndershëm digjen me votën e kartonave. Ju e keni bërë prej 13 vitesh. Kjo mazhorancë e Edi Ramës ka noterizuar kapjen e shtetit. Po e bëni dhe tani, duke refuzuar zbatimin e Kushtetutës, zbatimin e vendimeve detyruese të Gjykatës Kushtetuese.

Refuzoni të zhbëni ligjin për t’i hequr Ramës mundësinë e zhvatjes së tokës publike të Ramës për llogari të disa biznesmenëve. Me ligjin e investimeve strategjike i keni dhënë Ramës mundësinë të zhdukë 2.1 milionë metër katrorë tokë publike.

Vetëm dje në mbrëmje, ish-zv.kryeministri juaj shpalosi para shqiptarëve hartën e kapjes së shtetit. Rama merr vendimet, njerëzit e tij me emra të ndryshëm bëjnë pazare. Kompanitë shtetërore përdoren për të akumuluar pasuritë. Drejtësia vazhdon të ndëshkojë ndonjë vartës, por nuk prek atë që është koka, që është Edi Rama.

5 Elbasani nuk tanëgnatja peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

A ishit ju që votuat ligjin për krijimin e KAYO-s? Ju i dhatë kompanisë shtetërore prodhimin e armëve, pastaj KAYO u vendos nën përdorimin e mikut të Ramës, Yeffet. Është ky Roni që u dëgjua edhe mbrëmë që bënte pazare armësh me shtetas ukrainas, dhe ju heshtni.

Është i njëjti Ron që, sipas ish-ministrit tuaj, Rama donte t'i jepte menaxhimin e borxhit publik. Ju jeni të gatshëm të çoni skenarin e ri për grabitje. Pyesni sallën se për çfarë ju duheni ju Ramës këtë sesion.

Skandali i Ramës po përgatit tani, këtë herë me shëndetin e shqiptarëve. Modeli KAYO i raketës do të përdoret edhe për shëndetësinë. Nuk bëhet fjalë për një tender të vetëm, por për të gjithë sistemin. Sipas të dhënave të EUROSTAT-it, shqiptarët, në vend të shëndetësisë falas, tani paguajnë më shumë lekë se çdo vend tjetër i rajonit”, tha Bardhi.

#bardhi #Parlamenti #rama #VizionPlus



Taulant Halili

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



POLITIKË

Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor:...

Xhuljana Zhuleku 41 minuta më parë



POLITIKË

“Nuk po na lejohej të marrim nga qesja...”

Xhuljana Zhuleku Dje 21:49



POLITIKË

“Të dëgjojmë dhe të trajtojmë çdo...”

Xhuljana Zhuleku Dje 20:03



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.